
Lënda: Informacion i pjesshëm në lidhje me inspektimin e objekteve të finacuara nga Bashkia Tiranë për periudhën kohore nga viti 2010 deri në vitin 2018

Objekti: Rikonstruksioni i rrugës Piro Goda, Tiranë

Investitori: Bashkia Tiranë

Vlera e Investimit: 31,606,728 lekë

Periodha kohore: Qershor 2015 deri në Prill 2016

Inspektimi është kryer: Shkurt 2019

Ky objekt zbatohet në qytetin e Tiranës në një zonë periferike të saj, në anën Jugore të Spitalit Amerikan 3, e njohur edhe si zona e ish-Qytetit të Nxënësve. Segmenti rrugor nis nga bashkimi i rrugës "Piro Goda", me rrugën kryesore "Konferenca e Pezës" (rruga kryesore Tiranë -Kombinat) dhe përfundon në fund të këtij segmenti rrugor, me një gjatësi të përgjithshme rreth 440 ml. Gjendja ekzistuese e rrugës ka qenë e amortizuar, kjo edhe për shkak të mosinvestimit në të për një periudhë të gjatë kohore.

Projekti ka ndërhyrë në rehabilitimin e gjithë shtresave rrugore të trupit të rrugës (shtrimi me binder dhe shtrimin me asfalt), në rehabilitimin e nënshtresave të trupit të rrugës me të gjitha komponentët e saj (cakell+stabilizant) ku ajo ka qenë e dëmtuar, në rehabilitimin e rrjetin të ujrave të bardha, me sistemimin e kanalizimeve të pusetave të ujrave të zeza, në sistemimin e trotuareve, në rehabilitimin e rrjetin të ndriçimit, në sinjalistikë rrugore, rehabilitimin e mureve rrethuese të ndërtesave pranë kësaj rruge (sipas një modeli standard të miratuar), etj. Projekti i zbatimit ka parashikuar një rikonstruksion të përgjithshëm të këtij segmenti rrugor.



Fig. 1

Pavarësisht se investimi për rikonstruksionin e këtij segmenti rrugor është i viteve të fundit, në trupin e tij janë bërë një numër ndërhyrjesh të paplanifikuara, të cilat kanë dëmtuar integritetin e shtresave asfaltike



Punimet kanë filluar në Qershor 2015, ndërkohë që është bërë inagurimi për përfundimin e saj në muajin Prill 2016, që përkon edhe me përfundimin e deklaruar nga Bashkia Tiranë. Afati i garancisë së punimeve për këtë objekt ndërtimi është dy vjet. Pra rezulton se afati kohor i garancisë së punimeve të veprës, tashmë ka përfunduar. Zbatimi i punimeve është bërë në kushte optimale, pasi rruga gjatë periudhës së ndërtimit të saj ka qenë pothuajse e bllokuar. Edhe pse objekti sapo është përfunduar e duhet të jetë kryer edhe çbllokimi i Garancisë së punimeve nga Investitori, vlerësimi i punës së kryer për këtë investim mund të vlerësohet kalueshem.

Fig. 2
Kapaket e pusetave ne shume raste mungojne

Nga pamja vizuale e objektit konstatojmë se:

- Në trupin e rrugës u vunë re ulje dhe plasaritje te shtresave të asfaltit. Menjëherë pas përfundimit të këtij investimi po nga institucioni i Bashkisë Tiranë është ri investuar (ndërtim rrjeti KUZ), ku ndërhyrja e kryer edhe pse është asfaltuar dallohet plotësisht, për shkak të moslidhjes së saj në mënyrë uniforme me trupin e rrugës.

Fig. 3
Trotuaret ne shume raste jane nominale dhe shtresat asfaltike te riparimeve jane shtruar ne menyre te papershtatshme, duke demtuar dhe kunetat anesore te rruges



- Vihen re disa ulje, e thyerje të pllakave në trotuare. Trotuaret nuk janë uniformë e me gjerësi të njëtrajteshme në të gjithë gjatësinë e saj, edhe pse rruga ka pasur mundësi zgjerimi të mjaftueshëm. Nuk është ndërhyrë për prishjen & spostimin e mureve rrethuese të ndertesave, të cilat edhe pse duhet të jenë pa leje ndërtimi, zenë një pjesë të trotuareve të saj (segmenti në pjesën fundore). Edhe aty ku është bërë spostimi trotuaret janë shumë të ngushtë.



Fig. 4
Riparimet e kryera pas investimit fillestar dhe cilësia e ulet e materialeve e përdorur në ndërtimin e kornizave anësore të rrugës dhe kornizat e pusëve kanë kontribuar në demtimin e këtyre të fundit dhe prishjen e lidhjes mes materialeve të ndryshme përberese të rrugës.

- Nuk është realizuar sipas standartit të kërkuar lidhja e njëtrajteshme e trotuareve me trupin e rrugës për personat me aftësi të kufizuar (në disa segmente ato pothuajse mungojnë fare).
- Janë akoma pa u hequr lëndët e drurit të cilat janë përdorur për lënien e fugave në kornizat anësore të rrugës.

Edhe pse objekti ka vetëm dy vjet që është përfunduar, cilësia e punimeve të ndërtimit të veprës mund të vlerësohet kalueshëm. Bashkia Tiranë si Investitore e këtij objekti, ka gjithë detyrimin

ligjor për kontrollin e zbatimit të punimeve të ndërtimit (në cilësi dhe sasi). Jam i mendimit se nga Mbikqyrësi i punimeve, por edhe nga Bashkia Tiranë ka pasur neglizhencë gjatë marrjes në dorëzim të punimeve të këtij segmenti rrugor, me vlerë investimi të konsiderueshëm. Të gjitha defektet e shfaqura, bashkia do duhet tja kishte bërë prezente firmës zbatuese të punimeve, e cila do duhet të kryente riparimet e duhura, për të mos pritur degradimin e metejshëm të saj (fondi i garancisë së punimeve të objektit është 5% e vlerës së situacionit përfundimtar).

Konkluzione në lidhje me objektin.

- *Të behet riparimi i trotuareve duke zëvendësuar të gjitha pllakat e betonit të thyera, si dhe të riparohen uljet e tyre.*
- *Të riparohen të gjitha kalimet për personat me aftësi të kufizuar duke krijuar lidhje të njëtrajtshme të tyre, me trupin e rrugës e pa pengesa.*
- *Të bëhet riparimi i kunetave anësore të rrugës në pjesët e dëmtuara të saj, si dhe te hiqen fugat e drurit e të plotësohen me fuga betoni të varfër, konform kushteve teknike të projektimit e zbatimit.*
- *Sipas mendimit tonë vlera për riparimin e difekteve të vërejtura mendoj së zenë rreth 5 % të vlerës së situacionit përfundimtar.*
- *Bashkia para se të miratojë investimin për çdo segment rrugor duhet të bashkëveprojë me të gjitha institucionet e saj, në mënyrë që ndërhyrjet për rikonstruksione të bëhen brenda të njëjtit investim e të mos jenë të mbivendosura.*

Për të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarte të kontratave të zbatimit të punimeve, si dhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr 3, Datë 15.01.2001, Nr 2, datë 13.05.2005 dhe Nr 1, datë 16.06.2011, "Për mbikqyrjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".

Bashkëlidhur një foto ajrore e zonës ku është investuar.
(me vijë blu është shënuar rruga ku është kryer rikonstruksioni)

